

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-02/25
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	28.02.2025
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dytë (02) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.02.2025, duke filluar në ora 14:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nënkryetarin e Komunës së Junikut z.Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit më pas konstatoi se në mbledhje marin pjesë të 12 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leonora Shehu AD,znj.Vjollca Qestaj-DBF,z.Jetmir Jasiqi-DEZH, z.Zenun Shala DUKM, z.Fatos Shala-DSHMS, z.Demokrat Ganijaj-DSHPMSI.

Anëtarët prezent

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për Vitin 2025,
4. Informatë mbi gjendjen e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale,
5. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2024,
6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit dhe
7. Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua me 12 vota për, 0 vota kundër, dhe 0 vota abstenim.

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi, për këtë mbledhje mungojnë: z.leonard Lolluni-AAK, znj.Festina Maloku-AAK dhe Xhemë Tofaj-LVV.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka e qes ne votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar, kush është për? për 12 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se kaluar u miratua.

3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Prokurimit për Vitin 2025,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e planit të Punës së Prokurimit për vitin 2025 e beri z.Imer Gjota-Zyrtar në Prokurim, i cili fillimisht i përshebdeti të gjithë më pas e arsyetoi para anëtarëve të Kuvendit planin e punës së prokurimit për vitin 2025.

z.Zenel Maloku, përshendetje për të gjithë, mua po më vjen mirë që kontrata për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, është nënshkruar ne fillim të pranverës.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka , kalojmë në pikën e radhës së ditës.

4. Informatë mbi gjendjen e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve lokale,

Informaten e bëri z.Demokrat Ganiqaj-drejtor në DSHPMISI, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë më pas i informoi anëtarët e kuvendit mbi mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale.

z.Dervish bajraktari, përshëndetje për të gjithë, sa i përket kontratës për mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale, a mundemi me e ditë se çka përfiton operatori ekonomik, pasi që tashmë vetëm

po dalim ne stinën e pranverës, çfarë shume të pageses mer, si është kontrata? Edhe me sa e di unë për sa kanë zgjatur procedurat e prokurimit ata kanë dalur vullnetarisht për ti mirëmbajtur rrugët.

z.Demokrat Ganiqaj, kontrata është për aq sa kryen punë, edhe paguhet nga tani e tutje.

z.Lulzim Gacaferi, përshendetje për të gjithë, si prej tashi, këtu në materialin qe kemi është se aktualisht komuna e Junikut nuk ka kontratë per mirëmbajtje dimërore të rrugëve lokale.

z.Shpejtim Gacaferi, materiali na ka ardhur me kohë por informaten lidhur me këtë kontratë e morëm sot, për këtë arsyje në material qendron ajo informatë.

z.Lulzim Gacaferi, dimri tash me iku, kjo mirëmbajte a do të kryhet në pranverë.

z.Imer Gjota, procedurat kane filluar sipas planifikimit, por operatorët janë ankuat në OSHP dhe këto ankesa kan vonuar edhe nënshkrimin e kontratës.

z.Lulzim Gacaferi, kjo do të thotë se tani e tutje kemi kontratë, a mundemi me e ditë koston e kësaj kontrate dhe afatin e kontratës, dhe kush është operatori fitues.

z.Imer Gjota, afati i kontratës është 30 muaj dhe kostoja është 23500€ dhe paguhet nga komuna e Junikut, ndërsa operatori fitues është konsersiumi, "Arfa grup" dhe "V-Gaxherri."

z.Zenel Maloku, unë vetëm po dua me e ditë se çka paska pasur me ndodhë nëse do të kishte shumë borë dhe mos te kishin dalur këta vullnetarisht per ti mirëmbajtur rrugët, çka paska pasur me ndodhë me qytetarët, dhe kjo kontratë a është dashur të planifikohet te nënshkruhet në fillim të sezonës së dimrit, a nuk keni patur para, nuk keni pasur kohë apo nuk keni ditur?! Kjo po më intereson.

z.Demokrat Ganiqaj, edhe përkundër se nuk kemi pasur kontratë ne si komune posedojmë një automjet qe mundë të kryej këtë funksion dhe me kete mjet dhe me ndihmen e vullnetarëve ne kemi mirëmbajtur rrugët gjatë kësaj kohe edhe pse nuk ka patur edhe shumë reshje te borës përpos ne dy raste, më herët ne kemi pasur një kontratë për mirëmbajtje dimërore për rrugët lokale nga viti 2022 deri në fund të vitin 2024, në tetor të vitit 2024 kemi filluar procedurat e tenderimit për kontratë të re, dhe meqë operatorët jane ankuar ne OSHP ne nuk kemi mundur të nënshkruajmë kontratën e re pa një pergjigje nga OSHP-ja, dhe vetem po jau kujtoj se kontrata e fundit e nje kontrate per mirembajte dimërore ka qenë në vitin 2013 dhe nga ajo kohë nuk keni pasur kontratë tjetër kjo vetëm sa më jau kujtu juve si opozitë, ju me se pakti keni fëtyrë të folni për këtë çeshtje.

z.Zenel Maloku, ne këtu nuk po kërkojmë raport për vitet e kaluara, por çeshtja është këtu, për ata që shohin e dinë shumë mirë se sa reshje të borës ka pasur këtë dimër, aq borë e madhe ka ra sa traktori i komunës ka mbetur në rrugë shtatë ditë, e pa bllokuar edhe rrugën pa pikë bore.

z.Dervish Bajraktari, sa i përket qeverisë së kaluar, unë nuk besoj se qytetarët kanë pasur pakënaqësi, dhe sa i përket asaj se a kemi fëtyrë a nuk kemi, ti drejtor duhet ta keni parasysh se

ne jemi te zgjedhur nga populli dhe kemi fetyrë te themi gjithmonë për mos punën e tuaj apo për ndonjë punë që nuk e beni, andaj kujdes me fjalorin sepse je drejtor i komunës dhe po të kursejmë, sepse te kemi kursyer deri tani, e po te kursejmë edhe tash.

z.Sadri Krasniqi, përshendetje për të gjithë, mua po më intereson kur ka filluar procedura e prokurimit në tetorë sa ka qenë kostoja e kontratës, sepse ka fjalë të ndryshme dhe ne duam të dimë se kush kanë qenë operatorët që kanë punuar dhe sa ka qenë kostoja që ata kanë kërkuar për këtë kontratë, po ashtu po me intereson se sa ka qenë shuma në fillim të procedurës dhe sa është shuma që sot është nënshkruar kjo kontratë.

z.Demokrat Ganiqaj, kontrata është për 30 muaj, vlera e saj është 23500€, e njëjtë si në fillim të procedurave, në kontratë përfshihen pastrimi i rrugëve, hedhja e kripës dhe pastrimi i trotuareve, është kontratë në shërbim, aq sa shrytëzohet edhe paguhet.

z.Lulzim Gacaferi, pse ka zgjatur kaq shumë kjo përzgjedhje, ku ka qenë problemi, te operatorët apo ka pasur përzgjedhje të operatorit?

z.Besart Tofaj, përshendetje për të gjithë, ne si komune kemi inicuar procedurë të prokurimit në tetor të 2024, pas kësaj komuna ka bërë përzgjedhjen e operatorit, por me pas ka pasur ankesë në OSHP nga operatori tjetër dhe meqë çështja ka shkuar në OSHP komuna nuk ka mundur të vazhdojë me tutje procedurat deri në përgjigje të OSHP-se, përgjigjeja është kthyer këto ditë dhe ne të kemi edhe nënshkrimin e kontratës e cila është valide nga sot e tutje, siç edhe u cek nga zyrtari i prokurimit.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2024,

Sqarimin dhe arsyetimin e raportit të punës të komitetit për komunitete e bëri znj.Eliza Pepshi anëtare e këtij komiteti e cila fillimisht i përshendeti të gjithë e më pas e arsyetoi raportin para anëtarëve të kuvendit.

z.Sadri Krasniqi, unë në dy mandate kam qenë anëtar i këtij komiteti dhe e di rëndësinë e tij, tani e kemi si pikë të rendit të ditës raportin e punës për vitin 2024 dhe në sallë nuk është kryesuesja e këtij komiteti, nuk e di arsyeen pse, por mund të jetë arsyea se as kryesuesja e komitetit por edhe disa anëtarë të këtij komiteti nuk marrin mëditje edhe pse ky komitet është obligativ nga kuvendi dhe kjo mua më duket e pa drejtë që antarët e këtij komiteti të mos marrin mëditje për mbledhjet e mbajtura, unë kisha propozuar që mëditja që i ipet z.Zenel Maloku për këtë komiteti të muret dhe të shpërndahet për anëtarët tjerë të komitetit për komunitete.

z.Lulzim Gacaferi, nuk ka nevojë të muret mëditja z.Zenel Maloku, pasi që kuvendi komunal ka një buxhet prej 4000€ dhe nga këto të bëhet pagesa për këta anëtarë.

z.Zenel Maloku, mirë e tha z.Sadi Krasniqi, por edhe më mirë e cekti z.Lulzim Gacaferi, por për kundër kësaj, ky komitet ka një kohë shumë të gjatë që është pa një anëtar të komitetit dhe do

ishte mirë që ky anëtar të zëvendësohet dhe ky komitet të funksionoj normal, dhe çështja tjetër meqë kuvendi ka mjete pse mos te bejë pagesën e meditjeve për këta anëtar.

z.Shpejtim Gacaferi, fajet nuk janë te kuvendit për mos pagesën e meditjeve për këta anëtar, nuk është vetëm për anëtarët e komitetit për komunitete por edhe për anëtarë tjerë të komiteteve, është e pa drejtë që anëtarët e kuvendit të marrin meditje nëpër këto komitete e anëtarët tjerë që nuk janë pjesë e kuvendit të mos marrin por këtë ligj nuk e kemi bërë ne, kur i kemi nxjerrë rregulloret për këto komitete kemi nxjerrë vendim që secili anëtar i komiteteve të paguhet për meditjet, mirepor ministria e financave e ka bërë ligje që anëtarët që nuk janë pjesë e kuvendit të mos paguhën, ne si kuvend në kategorinë mallra dhe shërbime kemi një shumë prej 4000€, por nuk kemi kod për pagesën e anëtarëve të komiteteve, ndërsa sa i përket zëvedsimit të anëtares ka te bejë se ajo ka perfaqësuar OJQ te dhe ne do të bëjmë ftese OJQ ve qe të na sjellin një emër për anëtarë në këtë komitet qe ti përfaqësoj.

6. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

z.Zenel Maloku, unë deshta ta pyes drejtorin e shëndetësisë se a shkon ndonjëherë të punëtorët tu ti vizitosh e ti këshiloshë se si duhet të presin palen, po vetem kur të takohesh gjatë orarit të punës në kafe, e zyrën e leni te mbyllur, kjo është sa për fillim e më pas të sqaroj se pse po ti bejë këto pyetje?

z.Fatos Shala, përshendetje për të gjithë, po i vizitoj shpesh, i kemi edhe raportet e punës, unë e kam dëgjuar qe ka pasur një problem me ty qe nuk më ka ardhur mirë me zyrat e QSK, ai ka raportuar edhe për këtë situatë dhe unë kam dashur të degjoj edhe variantin tonë.

z.Zenel Maloku, kjo çështje ka të bejë për një ndihmë jo sociale për dy femijët e vajzës së ndjerë, e që ka gjashtë muaj që dokumentet i kemi dorëzuar në QSK-Junik, një herë na kanë thënë se nuk ju takojnë ngase kanë kërkuar autopsinë e prindërve të tyre, mendoj se autopsia QSK nuk i duhet, autopsia i duhet prokurisë gjyqësorë, QSK i duhet vetëm akti i vdekjes që e konstaton mjeku dhe dokumentet tjera, qe gjashtë muaj dokumentat janë atje dhe unë kam shkuar vet i dyti, dhe ne QSK e kam gjetur zyrtarin e kësaj qendre dhe ju kam drejtuar për këtë çështje a janë të gjitha dokumentet apo mungon donjë dokument, qe kete land ta dergoni për Prishtinë, dhe me është përgjigjur se landa është e kompletuar i ka të gjitha dokumente e kërkuara, para tri ditëve kam shkuar prap dhe e kam gjetur po këtë zyrtar duke folur në telefon, ka qenë ulur, është ngritur në këmbë dhe ka dal jashtë duke e vazhduar atë bisedë në telefon, është kthyer mbrenda dhe me bente me sheje se tani kthena dhe prap ka dalë jashtë ku pas dhjetë minutave është kthyer mbrenda, kjo është sjellja e punëtorit tuaj për kete kam edhe deshmitar, dhe kur është kthyer i kam thënë a e ke derguar lëndën për Prishtinë, me është përgjigjur jo, i kam thenë pse nuk e ke derguar, më është përgjigjur se punëtori tjetër nuk ka dalë në punë për dy ditë, e kemi pasur një ditë një mbledhje urgjente dhe na po lodhemi, kështu unë i kam thenë se a po lodhesh duke ngjehur automjete qe enden kësajde a ke pasur te ngarkuar diçka ne shpindë, me pas ndoshta jam dal edhe jashta rregulave i kam thenë turp për ty jo një herë, por pesdhjetë here, më është përgjigjur se shko ankohu në komune, i kam thenë se edhe komuna është kështu si ti, dhe unë mendoj se për gjashtë muaj te rrinë dokumentet në fijk te zyrtari dhe të mos dërgohen ne Prishtinë kjo nuk është në rregull, dhe e dyta në ora 08:40 zyra te jetë e mbyllur ne orar të punës dhe zyrtarët bashk me ty të jenë ne kafene duke pirë kafe, edhe kjo nuk është në rregull.

z.Lulzim Gacaferi, pyetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorin e shërbimeve publike, kur do ta sjellni ujin e pijes së Junikut ne Lagjen “Agim Ramadani”?

z.Besart Tofaj, ashtu siç e dini tash me me ujësjellësin dhe rrjetin e kanalizimit, si për mirëmbajtje dhe shtrimje te tyre meret kompanija e “Hidrodrinit”, komuna nuk e ka të drejtën e investimit përpos mbi bazën e vullnetit të mirë, por atë që komuna është duke e bërë vazhdimisht, është se jemi duke bërë kërkesë te vazhdueshme që “Hidrodrini” te bej shtrirjen e rrjetit të ujit të pijes edhe ne lagjen “Agim Ramadani” dhe kemi shprehur gadishmëri që edhe të bashkëfinancojmë nëse ky projekt niset, por deri me tani nuk kemi asnjë sinjal nga ana e tyre.

z.Sadri Krasniqi, unë deshta te pyes per gjendjen e shtratit lumit “Erenik”, a pritet të niset ndonjë iniciativë te pakten për pastrim, se për renovim po dihet se lypet më shumë kohë.

z.Demokrat Ganiqaj, në fund të vitit 2024, kam aplikuar ne ministinë e ambientit per pelqim ujqor të pastrimit të shtratit të lumit “Erenik”, në muajin e kaluar kanë adhur inspektorët nga ministria e ambientit dhe kanë parë gjendjen faktike te lumit dhe besoj se këto ditë do te na paisin me pëlqim ujqor dhe më pas ne do te vazhdojmë me pastrimin eventualisht me rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara që janë përgjatë shtratit të lumit.

7. Të ndryshme

z.Zenel Maloku, po lidhem prap me çështjen e parë, drejtor uroj ta keni kupuar mesazhin tim, unë dua te ankojem edhe per puntorët tuaj por edhe ne ty, dhe këtë ankesë po dua të di se ku ta bejë, sepse ne nuk i kemi derguar dokumentet, te mbesin aty ne fijosun e zyrtarirt.

z.Fatos Shala, unë e kam shënuar atë qe e the, dhe per këtë duhet të ndëgjohen të dy anët, se si edhe ana tjetër e ka arsyjen e vet, fillimisht po dua të tregoj se QSK_ja ka dy zyrtarë me nga shtatëdhjetetë detyra të punës që është e tepert, në mungesë te organit të kujdestarisë këta dy zyrtarë e luajn edhe rolin e kujdestarisë, ka raste qe i thrrasin në mesnatë dhe rste edhe ne mengjes të hershëm, për probleme familjare dhe duhet te shkojnë në polici sipas rasteve, në momentin kur ke shkuar ti zytari ka qenë në telefon, sepse ka qenë me orar që të shkoj të vizitoj nje femij të braktisur, te nesmeren kur na ke pa bashke, ne kemi qene duke mare disa gjera per ate femije, dhe duke e pritur qelsin e automjetit te komunes dhe te shkojme ne vendin ku eshte femija i braktisur, fjalosja mes teje dhe zyrtarit, as mua nuk me ka pelqy, ai ka thenë se ka biseduar ne telefon vetëm tre minuta dhe ju ka thenë juve qe të uleni të pritni dhe ka dal jasht dhe është kthyer, por edhe ligjërisht ata femije kane nje kujdestar dhe QSK_ja eshte vazhdimisht ne kontakt me te me gjithë respektin qe ju jeni gjyshi por ligjerisht kujdestari ka të drejtën, landa është në procedura nuk është se nuk është ka punohet në atë drejtim.

z.Dervish Bajraktari, çështja ka të bejë me shendetësi, më ka raststisur të shkojë këto ditë në QKMF, pata një plagë ta pastroj, kur shkoj aty pashë një rregullore se pas ora 21:00 qyteatrët nuk munden te marin infuzion, nuk pastrojmë plagë perpos në raste urgjente, dhe kur funksioni i QKMF_se është 24 orë dhe aty ka motra medicinale dhe mjeket janë aty, pse te meret ai vendim nga drejtori i QKMF_se, çështja tjetër ka të bejë me ndriqimin publik, nëse shkoni pergjatë lumit erenik natën aty do te shikoni se nuk ka ndriqim publik, nga ura e ne drejtim te qendrës nuk ka ndriqim, përpos rruga në drejtim të lagjes “Agim Ramadani” që ka ndriqim publik pjesët tjera të

komunës nuk kan, a ne facebook keni postuar se ne komunën e Junikut është kryer ndriqimi publik, poashtu ky është viti i fundit i këtij mandati ne që tri vite jemi duke e përmendur gjendjen e shtratit të lumit “Erenik”, premtimet nga ju ka qenë se do ta beni, por deri tasni nuk ka asgjë, ka mbet vetem premtim, uji i pijes per Lagjen “Agim Ramadani”, komuna ka mundur të ndermerr hapa ne kete drejti qe lagjeja Agim Ramadani te kete ujin e pijes se pjesa tjetër e komunës së Junikut, këto projekte qe i permenda keni mundur ti kryeni, sepse janë jetike për qytetarët dhe me pak para do kishit mundur ti bëni.

z.Fatos Shala, arsyjea eshte se mbas ores 21:00 është ne funksion vetëm emergjencia pra vetëm per raste emergjence, dhe arsyja e vendimit që është marrë është se ka pasur raste qe shumë persona kane pritur rastin qe nje infuzion qe kan mundur ta marin terë ditën te shkojnë ta marin mbas ores 21, por ka të bejë edhe me staf, nuk ka staf te mjaftusehëm që në rast se ka raste emergjence nuk mund te meren edhe pacientin qe mer infuzion edhe me rastin emergjent, per ketë arsyje eshte marë ky vendim.

z.Demokrat Ganijaj, sa i perket ndriqimit pergjatë shtratit të lumit “Erenik”, ne kemi inicuar procedurat e prokurimit qe edhe ne kete pjesë të ketë ndriqim publik por pas vërshimeve kemi konstatuar qe duhet te intervenohet nga fillimi ne atë pjesë që të ketë ndërtim edhe të shtratit edhe të ketë ndriqim publik, ndersa sa i perkete pjeve tjera te komunes se Junikut, komuna e Junikut është e mbuluar me ndriqim publik deri ne 95% , ne lagjen “Bajraktar” ka një defekt dhe që tri ditë është pa ndriqim publik, këto ditë e kemi informuar operatorin ekonomik dhe do të vinë e ta riparojë atë defekt, ndërsa sa i perket lumit “Erenik” e tham edhe ma herët se ka demtime te mdha ngjate vershimeve dhe ktu duhet qe te intervenohet nga fillimi dhe ka një kosto të lartë dhe besoj se në mandatin e ardhshëm do ta perfundojmë.

z.Lulzim Gacaferi, çeshtja ka te bejë me ndërtimin e rrugës në drejtim të shtëpisë së Edmond Hoxha, dhe aty pashë se jeni ka doni të ndërtoni trotuar me gjerësi prej 30cm, nëse nisemi në bazë te projektit në të parashihet që trotuaret të jenë sipas standardeve europiane, po du të di se ku qendron problemi, kush jau ka dhenë atë ide që aty të ndërtoni trotuar 30cm të gjerë,poashtu kam edhe një çeshtje tjetër, nga rruga “Shkelzen Gacaferi” në drejtimrtim të Shkollës fillore kam pa se aty kan filluar punimet po dua të di se çka keni parapa aty të ndërtoni, dhe aty pashë se trashësija e armatures për muret mbrojtës ishte 4mm, dhe ne e dimë se kjo është e pa mjaftushme për muret mbrojtës.

z.Zenun Shala, përshëndetje për të gjithë, rruga nga shtëpia e Edmond Hoxha në drejtim të rrugës Fadil Maloku, në atë pjesë nuk kemi paraparë trotuar fare, por ajo qe po e thuani eshte bankinë e rrugës nuk është trotuar, ndërsa sa i perket ndërtimit të rrugës te shkolla, aty tre pronar na e kan lëshuar hapsirë nga prona e tyre me shumë se sa dy pronaret e tjerë, kështu që kemi qenë të detyruar ta ndërtojmë rrugë aq sa na e kanë lejuar, ne e dimë shumë mirë gjendjen se si ka qenë në atë rrugë, ndersa sa i perket armatures ne kemi berë vërejtje operatorit dhe operatori ka premtu se do ta kete parsysh ketë vërejtje.


z.Zenel Maloku, desha të di nga drejtori i Urbanizimit, desha te di ura e ndertuar se fundmi ne fshatin Jasiq a është ndërtuar me projekt a pa projekt, dhe nëse është kryer me projekt a kisha mundur ta kem atë projekt.

z.Zenun Shala, ura ka projekt, dhe atë projekt mund ta keni kur të doni.

z.Shpejtim Gacaferi, e shpalli te mbyllur mbledhjen e Shkurtit 2025

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha



Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi
